

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papa Leoni, vizitë në Francë/ Pritet nga presidenti Macron në Elysee
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/papa-leoni-vizite-ne-france-pritet-nga-presidenti-macron-ne-elysee-i588435
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 19:30:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	76a2796df192545c1d6ab3100648ac2e95aae86ba111d373a006221a7880001c
TEKSTI	eea195dac1d3723904c710cb1b0974aef7c3458aa7f64cdaa17e5b264934ede3
PAMJA	966e265bd4c43dee9125e76cf0ba9a52d2ef3472612a54063dd486568e532afd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2a1159d43ee869ccb4e954c8504a5f66012ff3adaad6d95c6a5669c38d089397
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2a1159d43ee869ccb4e954c8504a5f66012ff3adaad6d95c6a5669c38d089397>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le Papa Leoni, vizite ne France/ Pritet nga presidenti Macron ne Elysee/jala e PLOTE/ Edi Rama ne OKB: Makineria e Inteligjences Artificiale do te bindet, pyetja eshte 'kujt' fundit

Papa Leoni, vizitë në Francë/ Pritet nga presidenti Macron në Elysee



25 Shtator 2026, 21:30Bota TEMA



Me nje pritje madheshtore Papa Leone i 14 nisi këtë të premtë vizitën e tij 4 ditore në Francë, në udhëtimin e tij të parë në këtë vend, me një axhendë që pritet të përqendrohet te paqja në një kohë konfliktesh, sfidat e inteligjencës artificiale dhe reflektimi mbi vlerën dhe dinjitetin e jetës njerëzore. Gjatë vizitës, Papa do të qëndrojë në Paris, do të vizitojë shenjtëroren katolike të Lourdes dhe qytetin Metz, në verilindje të Francës.

Mbërritja e tij në aeroportin Orly të Parisit u shoqërua me tingëllimin e kabanave të kishave në të gjithë Francën. Autoritetet presin që më shumë se një milion njerëz të dalin në rrugë gjatë vizitës, e cila vjen 18 vjet pas vizitës së fundit të një pape në Francë. Në aeroport, Leo XIV u prit nga presidenti francez Emmanuel Macron. Kreu i Kishës Katolike Romake mbajti një takim me Macon në Pallatin Elize ku mbajti një fjalim për të pranishmit, një fjalim i cili u dominua në shqetësimet Kryesore të Papes në Lidhje me Abortin i cili është përfshirë në Kushtetutën Franceze si e drejtë që prej vitit 2024, si dhe mbi vdekjen e asistuar të cilën Kisha Katolike e refuzon.

"Ndonjëherë jam i shqetësuar nga ato trende në shoqëri që rrezikojnë ta shndërrojnë shkencën dhe teknologjinë në sipërmarrje fitimprurëse që promovojnë manipulimin gjenetik, zëvendësimin, tregtinë e organeve njerëzore ose mundësinë e organizimit të vdekjes së dikujt. E përsëris me vendosmëri se mbrojtja e të drejtës për jetë përbën themelin e domosdoshëm të çdo të drejte tjetër njerëzore"

Axhenda e kesaj te premtjeje e ngjeshur per Leonin e 14 . Papa do të mbajë një fjalim në selinë e UNESCO-s, do të marrë pjesë në lutjet e mbrëmjes në katedralen Notre-Dame, e cila është rihapur pas restaurimit, dhe më pas do të drejtojë një vigjilje të madhe me të rinjtë në stadiumin e Parisit. Vizita po shoqërohet me masa të jashtëzakonshme sigurie. Policia franceze ka vendosur në terren një operacion të krahasueshëm me masat e marra gjatë Lojërave Olimpikë dhe Paralimpikë të Parisit në vitin 2024.

Masat përfshijnë, ekspertë për çaktivizimin e bombave, sisteme kundër dronëve dhe njësi kundër terrorizmit. Vetëm në Paris, këtë të premtë janë angazhuar rreth 14 mijë policë, xhandarë dhe pjesëtarë të forcave ushtarake, si dhe rreth 2 mijë e 500 zjarrfikës.

Autoritetet kanë krijuar një perimetër të gjerë sigurie rreth zonave ku do të zhvillohen aktivitetet e Papës, ndërsa rreth tij do të vendosen edhe perimetra të tjerë mbrojtës.

Vizita katërditore e Leo XIV në Francë pritet të jetë një nga udhëtimet më të rëndësishme ndërkombëtare të pontifikatit të tij, duke bashkuar mesazhet e Kishës

per paqen dhe dritet e njerezor me debatet e Evropes mbi teknologjine, dhe te ardhmen e shoqense.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Megaskandali me fondet e investimeve në Turqi, autoritetet marrin nën hetim 76 persona, arrestohen 45 prej tyre](#)

Putin: Gati për bisedime me Kievin pas zgjedhjeve, por Ukraina do të vuajë pasojat e sulmeve ndaj civilëve

21:00 Bota

[Bill Gates: Inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një miliard njerëzve](#)

20:15 Bota / 2 komente

[Aeroporti i Milano Malpensa merr emrin e Silvio Berlusconi-t, e bija e ish-kryeministrit të ndjerë: Krenari e madhe](#)

19:25 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.